



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe
Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 20/18
Prishtinë, më 28.03.2018, në orën 12:30
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhjen e përbashkët morën pjesë nga Komisioni për Buxhet dhe Financa: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Ali Lajçi, Naser Osmani, Enver Hoti, Fikrim Damka, Dardan Molliqaj dhe Blerim Kuçi.

Munguan: Jelena Bontiç, Mërgim Lushtaku.

Pjesëmarrës të ftuar: Fatmir Gashi – Zëvendës- Ministër i Financave (tash e tutje Zëvendës-Ministri i Financave) dhe Faton Hamiti-Zyrtar i lartë për legjislacion - Drejtoria për Standardizim, Përafrim dhe Harmonizim Ligjor e Administratës së Kuvendit.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Dashurije Canolli, Luljeta Krasniqi dhe Eliza Hyseni(praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i komisionit – Lumir Abdixhiku (tutje: kryetari).

R e n d i i d i t ë s :

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 14.03.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim;**
- 4. Projektligji nr.06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;**
- 5. Projektligji nr.06/L-026 për Azil dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;**
- 6. Projektligji nr.06/L-029 për mbrojtje dhe siguri bërthamore dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
- 7. Projektligji nr.06/L-037 për Metrologji dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;**

8. Projektligji nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoi se rendi i ditës miratohet unanimisht pa ndryshime

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.03.2018

Kryetari - konstatoi se komisioni unanimisht miratoi procesverbalin, e mbledhjes së mbajtur më 14.03.2018, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

Kryetari - Projektligji në fjalë në lexim të parë është bërë në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në seancë është prezantuar nga po i njëjti Komision, por është vendosur që ti kalohet Komisionit tonë për shqyrtim të dytë sepse është adresuar atje gabimisht.

Zëvendës-Ministri i Financave - draftligji është edhe pjesë e Agjendës së Reformave dhe ky projektligj rregullon sistemin e kontabilitetit dhe raportim financiar të shoqërive tregtare, kompetencave dhe përgjegjësitë e Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, kërkesat për auditim, kualifikimet për kontabilist profesional, licencimin e auditorëve dhe firmave vendore e të huaja të auditimit si dhe organizimin e Organizatave Profesionale të Kontabilitetit. Në kontekstin e harmonizimit të Institucionit Nacional në këtë rast të BE-së, Ligji për Kontabilitet Financiar dhe Raportim adreson plotësisht kërkesat përkatësisht e legjislacionit të BE-së. Vlen të theksohet se Ministria e Financave ka zhvilluar të gjitha fazat e konsultimeve për projektligj dhe të gjitha komentet e pranuar janë ndryshuar nga gjyqëtarët përkatës për të adresuar më pas në projektligj. Projektligji nuk ka kosto shtesë buxhetore. Banka Botërore e bënë vlersimin gjendjes së kontabilitetit në Kosovë dhe harton një raport i cili është i njohur si ROS përmes të cilit ka insistuar që ligji që ka qenë në fuqi të harmonizohet me direktivat e BE-së dhe ka qenë baza kryesore ku Ministria e Financave e mbështet dhe ka inkorporuar shumicën e kërkesave direktivave evropiane.

Faton Hamiti - theksoi se tek neni i 1 paragrafi 2, nënparagrafët 2.1-2.4 janë përmend disa direktiva të BE-së dhe nëse bëjmë krahasime me tekstin e gjuhës angleze teksti i gjuhës shqipe nuk është i plotë dhe kam sugjeruar që të riformulohet kjo pjesë në mënyrë që të jetë në harmoni me tekstin burimor të direktivave të BE-së.

Kryetari : Konstatoj se Komisioni miratojë amendamentin, si vijon: “Neni 1, në paragrafët 2.1 deri në 2.4., riformulohen me tekstin si në vijim:

2.1. Direktivën 2006/43/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 17 maj 2006, për auditimet ligjore të pasqyrave vjetore financiare individuale dhe pasqyrave financiare të konsoliduara, që ndryshon Direktivat e Këshillit 78/660/EEC dhe 83/349/EEC dhe shfuqizon Direktivën e Këshillit 84/253/EEC.

2.2. Direktivën 2008/30/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 mars 2008, për ndryshimin e Direktivës 2006/43/EC për auditimet ligjore të pasqyrave vjetore dhe pasqyrave të konsoliduara, lidhur me kompetencat zbatuese dhënë komisionit.2.3. Direktivën 2013/34/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 qershor 2013,për pasqyrat vjetore financiare individuale, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet përkatëse të llojeve të caktuara të

ndërmarrjeve, që e ndryshon Direktivën 2006/43/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe shfuqizimin e Direktivës 78/660/EEC dhe 83/349/EEC.

2.4. Direktivën 2014/56/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 16 prillit 2014, për ndryshimin e Direktivës 2006/43/EC për auditimet ligjore të pasqyrave vjetore financiare individuale dhe pasqyrave financiare të konsoliduara”.

Faton Hamiti - te qëllimi i projektligjit i referohet vetëm shoqërive tregtare tek neni 1 paragrafi 1 i cili lidhet pastaj me nenin 3, kam vërejtje sepse qëllimi i ligjit vlen vetëm për shoqëritë tregtare dhe jo për subjekte të tjera. Prandaj, rekomandojë të fshihet teksti “subjektet të tjera”.

Kryetari: Konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon: Neni 3, në përkufizimin: “1.3.Raporti vjetor”, fshihet teksti “dhe subjektet tjera”.

Faton Hamiti - në nenin 3 përkufizimi “Materialiteti” nuk e kam has askund pra në fakt nuk është përdorur dhe termat e panevojshëm nuk rekomandohet të jenë këtu sepse na konfuzojnë.

Zëvendës-Ministri i Financave - kjo ka të bëjë me raportin e auditimit, në qoftë se ka shkelje në raport të auditimit përdoren shkeljet materiale të rasteve të caktuara.

Kryetari - Konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon : Neni 3, përkufizimi: “1.26. Materialiteti”, fshihet në tërësi.

Faton Hamiti - në nenin 4 paragrafin 3 parasheh nxjerrjen e akteve ligjore për të cilin vlen interpretimit të kësaj dispozite dhe e len si organ përgjegjës KKRF-në mirëpo ne konsiderojmë se kompetencë e Ministrisë është nxjerrja e akteve nënligjore.

Zëvendës-Ministri i Financave - KKRF-ja është organ i pavarur i Qeverisë i cili rregullon një materie të caktuar dhe e ka për obligim me nxjerrje akte nënligjore që e rregullojnë çështjen e standardeve të kontabilitetit , raportimit financiar dhe auditimit .

Naser Osmani - asnjë akt nënligjor nuk mundet me u nxjerrë nëse nuk e aprovon Qeveria.

Kryetari - konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon : Neni 4, paragrafi 3, në rreshtin e katërt, fshihet fjala “nënligjore”. Neni 9, në rreshtin e tretë, fshihet fjala “nënligjore”. Neni 23, paragrafi 5, në rreshtin e parë, fshihet fjala “nënligjor”. Neni 29, paragrafi 5, në rreshtin e dytë, fshihet fjala “nënligjor”. Neni 30, paragrafi 5, në rreshtin e parë, fshihet fjala “nënligjor”.

Vilson Ukaj - tek neni 5 paragrafi 7 përkufizimi të këtij paragrafi nuk tregohet saktë cilit paragraf i referohemi dhe siç është shkruajtur në projektligj, referenca e këtij paragrafi nuk flet për klasifikime.

Kryetari - konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin i cili riformulohet me tekstin si vijon : Neni 5, në paragrafin 7, referenca “të këtij paragrafi”, ndryshohet në referencën “të paragrafit 6”.

Faton Hamiti - në nënparagrafin 1.2 të nenit 7 përdoret termi “zyrtar kryesor për financa”, ndërsa në pjesët tjera të projektligjit “zyrtari kryesor financiar”. Rekomandimi është të bëhet harmonizimi i termit në tërë tekstin e projektligjit. Po ashtu tek nënparagrafi 1.3 dispozita i referohet vetëvetës dhe nuk duhet të jetë kështu. Ndoshta, mund të fshihet si e panevojshme.

Kryetari - konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon :

“Neni 7, paragrafi 1, në nënparagrafin 1.2, teksti: “zyrtari kryesor për financa”, ndryshohet me tekstin “zyrtari kryesor financiar”.

Neni 7, paragrafi 1, në nënparagrafin 1.3., fshihet teksti: “sipas këtij nënparagrafi”.

Faton Hamiti – në paragrafin 4 neni 7 paragrafi është reference e gabuar sepse po i referohet vetvetës andaj duhet të përmirësohet.

Kryetari - Konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon:

Neni 7, në paragrafin 4, referenca “paragrafin 4”, ndryshohet në referencën “paragrafin 3”.

Vilson Ukaj- tek paragrafi 5 duhet të shtohet fjala “ vite”.

Kryetari - Konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon :

Neni 7, në paragrafin 5, pas fjalës “tri (3)”, shtohet fjala “vite”.

Faton Hamiti - e kam një pyetje lidhur me termin “deklaratë e pajtueshmërisë” dhe termi i panjohur i cili përdoret në projektligj, duhet të përkufizohet.

Zëvendës-Ministri i Financave - sqaroi se kur të lexohet raporti financiar vjetor bëhet një deklaratë e pajtueshmërisë, në qoftë se ai raport financiar nuk është i saktë dhe të dhënat devijojnë jashtë standardeve. Megjithatë, ne do të sjellin përkufizimin e deklaratës financiare, që ti shtohet përkufizimeve të projektligjit.

Kryetari - konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon :

1.37. **Deklarata e Pajtueshmërisë** – është deklaratë e cila përcakton politikat e ndërmarrjes, të cilat sipas opinionit të drejtorëve janë përmbushur krahas obligimeve relevante të tyre.

Faton Hamiti - në nenin 10 paragrafi 8 , përdoret termi “tarifa kontigjente”, por që nuk është dhënë përkufizimi për të.

Kryetari - konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon :

1.38. **Çmimet kontigjente** - janë çmime të përcaktuara, bazuar në rezultatet e punës së auditorit. Nënkupton që auditorët ligjorë apo firmat e auditimit ligjor nuk duhet të krijojnë marrëdhënie kontraktuale me çmime kontigjente për auditim apo shërbime të tjera të dhënies së sigurisë (assurance), pasi që marrëdhëniet e këtilla kontraktuale prodhojnë situatë të konflikt të interesit.

Faton Hamiti – në nenin 11 rekomandohet një organizim të këtij paragrafi 4 dhe 5 të këtij neni.

Zëvendës-Ministri i Financave - janë përmendur librat mbështetës dhe të gjitha llojet e librave që janë në kontabilitet dhe ka fillu me spjegu çka është libri kryesor. Libri kryesor është obligativ këta tjerët janë ndihmës.

Faton Hamiti - atëherë nëse këta janë nënlibra atëherë nuk është e arsyeshme me qenë fare këtu ose me i cek në kuadër të librit kryesor.

Naser Osmani – propozojë që të fshihet paragrafi 4 i neni 11.

Kryetari -konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon :

Neni 11, fshihet paragrafi 4 në tërësi. (Në vazhdim bëhet rinumërimi i paragrafëve)

Faton Hamiti – në nenin 14 paragrafi 2 duhet të përcaktohet me cilin ligj është fjala.

Kryetari - konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon :

Neni 14, paragrafi 2, teksti: “dispozita të veçanta”, ndryshohet me tekstin: “legjislacionit në fuqi”. Po ashtu, teksti: “me ligjin dhe dispozitat e tilla”, ndryshohet me tekstin: “me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.”

Vilson Ukaj – në nenin 19, paragrafi 1 teksti “përcaktohet nga Ministria e Financave” të ndryshohet me tekstin “të këtij neni përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Financave.”

Kryetari - konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon :

Neni 19, paragrafi 2, teksti: “më sipër përcaktohet nga Ministria e Financave”, ndryshohet me tekstin: “të këtij neni përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Financave.”

Naser Osmani – në nenin 20, paragrafi 4 fjala gjithmonë të hiqet sepse përgjithmonë vetëm Deklarata e Pavarësisë ka një mandat të tillë dhe të bëhet në afat të pacaktuar.

Kryetari - konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon :

Neni 20, paragrafi 4, fjala “përgjithmonë”, ndryshohet me fjalët: “në afat të pacaktuar”.

Faton Hamiti – në nenin 21 paragrafi 4.4. thotë ndër tjera të mos jetë i dënuar për veprë penale , unë propozoj që të shtohet me vendim të formës së prerë sepse personi mundet me u dënu por ka shkallshmërinë e ankesave.

Zëvendës-Ministri i Financave – personat e emëruar në KKRF në momentin kur emërohet nuk duhet me qenë të dënuar se a janë në përfundim apo në procedure nuk është me rëndësi.

Naser Osmani - ju nuk mund të thoni i dënuar me burg, ai mundet me qenë i dënuar edhe në forma tjera, do të thotë askush nuk është i fajshëm nëse në proces gjyqësor nuk konsiderohet i fajshëm.

Kryetari - konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon :

Neni 21, paragrafi 4, në nënparagrafin 4.4., teksti: “për më tepër se gjashtë (6) muaj me burgim.”, ndryshohet me tekstin “me aktgjykim të formës së prerë, më tepër se gjashtë (6) muaj.” Po ashtu në nenin 30, paragrafi 1, në nënparagrafin 1.6., në rreshtin e dytë, pas fjalës “penale”, shtohet teksti “me aktgjykim të formës së prerë”.

Faton Hamiti - neni 24 paragrafi 5 nuk sqarohet se kush e aprovon procedurën?

Kryetari - konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon :

Neni 24, paragrafi 5, në fund të fjalisë, pas fjalës “transparente”, shtohet teksti: “ të përcaktuar me akt nga KKRF-ja.”

Faton Hamiti – në nenin 28, në titullin e këtij neni, fjala “Ndalimi” të zëvendësohet me fjalën “Parandalimi”.

Kryetari - konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon :

Neni 28, në titullin e këtij neni, fjala “Ndalimi”, zëvendësohet me fjalën “Parandalimi”.

Faton Hamiti – në nenin 36, paragrafi 2 është një reference e ligjit e cila nuk preferohet të jetë aty, gjithmonë i referohemi emërimit të ligjit e jo numrit.

Kryetari - konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon :
Neni 36, paragrafi 2, teksti: “me nenin 29, paragrafi 3, i Ligjit nr.05/L-087 për Kundërvajtje”, ndryshohet me tekstin “me Ligjin për Kundërvajtje”. Si dhe në nenet 38, 39 dhe 40, bëhen nene 37, 38 dhe 39.

Faton Hamiti – në Kapitullin VIII, të shtohen fjalët “DHE PËRFUNDIMTARE”.

Kryetari - konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon:
Kapitulli VIII, në titullin e këtij kapitulli, pas fjalës “KALIMTARE”, shtohen fjalët: ‘DHE PËRFUNDIMTARE’.

Faton Hamiti - te neni 38 ,paragrafi 2 unë e kam bërë një riformulim :
Me kusht që mos të jenë në kundërshtim me këtë ligj dhe deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore për zbatimin e këtij ligji, aktet nënligjore të zbatueshme do të vazhdojnë të mbesin në fuqi.

Kryetari - konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon :
Neni 38 (i ndryshuar si neni 37), paragrafi 2, ndryshohet me tekstin si vijon:
2. Me kusht që mos të jenë në kundërshtim me këtë ligj dhe deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore për zbatimin e këtij ligji, aktet nënligjore të zbatueshme do të vazhdojnë të mbesin në fuqi.

Faton Hamiti - neni 39 duhet të përmirësohet, pasi që është praktikë që të përcaktohet një afat kohorë për nxjerrjen e akteve nënligjore. Gjithashtu, duhet të përfshihet edhe Ministria e Financave, pasi që edhe ajo nxjerrë akte nënligjore sipas këtij ligji.

Kryetari - konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon :

Neni 39 (i riformuluar si neni 38), ndryshohet me tekstin si vijon:

Neni 38 **Aktet nënligjore**

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj, hyjnë në fuqi, ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Kryetari - projektligji poashtu përmbanë edhe disa gabime teknike dhe gjuhësore, të cilat janë evidentuar nga stafi mbështetës të cilat propozoj që ti miratojmë si një amendament i vetëm.

Kryetari - konstatohet se Komisioni miratohet amendamentin me tekstin si vijon :
Neni 3, përkufizimi “1.2. Sistemi kontabël”, në rreshtin e pestë, fjala “disenjuara”, ndryshohet me fjalën “dizajnuara”

Neni 3, përkufizimi “1.35. Ekstrapolim”, në rreshtin e pestë, lidhëza “i”, ndryshohet me lidhëzën “të”

Neni 3, përkufizimi “1.26. Materialiteti”, fjala “natyrë”, zëvendësohet me fjalën “natyra”.

Neni 5, paragrafi 3, në nënparagrafin 3.2., fjala “dje”, zëvendësohet me lidhëzën “dhe”.

Neni 7, paragrafi 3, në rreshtin e dytë, pas fjalës “të qeverisjes”, shtohet lidhëza “së”.

Neni 7, paragrafi 5, në rreshtin e tretë, pas fjalës “tyre”, shtohet pjesëza “të”.

Neni 8, paragrafi 1, në nënparagrafin 1.3., në rreshtin e katërt, fshihet lidhëza “e”.

Neni 10, paragrafi 8, në rreshtin e dytë, fjala “kontingjente”, ndryshohet me fjalën “kontigjente”.

Neni 13, paragrafi 1, fjala “gjuhën”, ndryshohet me fjalën “gjuhët”.

Neni 17, paragrafi 2, në rreshtin e dytë, pas fjalës “pajtim”, shtohet parafjala “me”.

Neni 20, paragrafi 4, në fillim të fjalisë, pas fjalës “pagave”, hiqet shenja e pikësimit presje “,”.

Neni 20, paragrafi 4, në rreshtin e tretë dhe të tetë, fjala “paketën”, zëvendësohet me fjalën “paktën”.

Neni 22, paragrafi 1, nënparagrafin 1.2., në rreshtin e dytë, pas shkurtesës “SNK-të”, shtohet lidhëza “e”

Neni 22, paragrafi 1, nënparagrafin 1.5., në rreshtin e parë hiqet lidhëzat “e” dhe pjesëza “të”.

Neni 22, paragrafi 3, nënparagrafin 3.8., në rreshtin e pestë, nyja “të”, zëvendësohet me nyjën “i”.

Neni 22, paragrafi 4, në rreshtin e katërt, fshihet fjala “pranë”.

Neni 23, paragrafi 4, në nënparagrafin 4.4., nyja “i”, zëvendësohet me nyjën “të”.

Neni 23, paragrafi 4, në nënparagrafin 4.5., pas fjalës “janë”, shtohet pjesëza “të”.

Neni 24, paragrafi 1, fjala “funksionin”, ndryshohet me fjalën “funksionon”.

Neni 24, paragrafi 2, në rreshtin e shtatë, fjala “natar”, zëvendësohet me fjalën “anëtar”.

Neni 24, paragrafi 4, në rreshtin e parë, fjala “inspektimit”, zëvendësohet me fjalën “inspektimet”.

Neni 24, paragrafi 8, në fund të këtij paragrafi, fjala “trajtua”, zëvendësohet me fjalën “trajtuar”.

Neni 24, paragrafi 12, në rreshtin e parë, pas fjalës “deri”, shtohet lidhëza “më”.

Neni 25, paragrafi 1, në nënparagrafin 1.1., lidhëza “lë”, zëvendësohet me lidhëzën “që”.

Neni 26, paragrafi 1, në rreshtin e parë, fjala “viti”, zëvendësohet me fjalën “vit”.

Neni 28, paragrafi 1, në nënparagrafin 1.2., në rreshtin e katërt, lidhëza “e”, zëvendësohet me lidhëzën “dhe”.

Neni 32, paragrafi 2, në rreshtin e katërt, fjala “kompanie”, zëvendësohet me fjalën “kompanisë”.

Neni 33, paragrafi 1, në rreshtin e parë, fjala “licençohet”, zëvendësohet me fjalën “licençohen”.

Neni 34, paragrafi 3, në nënparagrafin 3.2.4., fjala “sa si”, zëvendësohet me fjalën “sasi”.

Neni 35, paragrafi 1, në rreshtin e tretë, fjala “pozitës”, zëvendësohet me fjalën “pozitën”.

Neni 36, paragrafi 1, në rreshtin e tretë, fjala “paraparë”, zëvendësohet me fjalën “parapara”.

Neni 36, paragrafi 3, në nënparagrafin 3.10.3, fjala “përputhej”, zëvendësohet me fjalën “përputhje”.

Neni 36, paragrafi 3, në nënparagrafin 3.11.10., fjala “kontaktuar”, zëvendësohet me fjalën “kontraktuar iu”.

Neni 36, paragrafi 3, në nënparagrafin 3.11.11., fjala “presës”, zëvendësohet me fjalën “prerë”.

Neni 36, paragrafi 3, në nënparagrafin 3.11.14, fjala “kryen”, zëvendësohet me fjalën “kryhen”.

Neni 36, paragrafi 4, në rreshtin e katërt “masat”, zëvendësohet me fjalën “masave”.

Kryetari – konstatoi se Komisioni pas diskutimeve dhe propozime, shqyrtoj dhe amendamentojë Projektligjin nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe raportin me amendamente e procedon për shqyrtim në Komisionet tjera të Përhershme.

4. Projektligji nr.06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së

Kryetari - theksoi se në bazë të Deklaratës Financiare të Ministrisë së Financave, shifet se Projektligji nuk përmbanë kosto shtesë buxhetore. Por as amendamentet e Komisionit Funksional, nuk përmbajnë kosto buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se komisioni, unanimisht, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt dhe amendamentet e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, nuk përmbajnë kosto buxhetore shtesë.

5. Projektligji nr.06/L-026 për Azil dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se komisioni, unanimit, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-026 për Azil dhe amendamentet e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, nuk përmbajnë kosto buxhetore shtesë.

Kryetari - theksoi se në bazë të Deklaratës Financiare të Ministrisë së Financave, shifet se Projektligji nuk përmbanë kosto shtesë buxhetore. Por as amendamentet e Komisionit Funksional, nuk përmbajnë kosto buxhetore shtesë.

6. Projektligji nr.06/L-029 për mbrojtje dhe siguri bërthamore dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetari - theksoi se në bazë të Deklaratës Financiare të Ministrisë së Financave, Projektligji përmbanë kosto shtesë buxhetore. Kam diskutuar me Ministrin e Financave, dhe ka thënë se kostoja buxhetore është e përballueshme. Ndërsa, amendamentet e Komisionit Funksional, nuk përmbajnë kosto buxhetore shtesë.

Zëvendës-Ministri i Financave – janë paraparë tre zyrtarë për zbatimin e këtij ligji në buxhetin 2018, si dhe buxheti për paga dhe mëditje për këta zyrtarë. Për vitin 2018, nuk ka kosto shtesë buxhetore, për vitet e ardhshme do të ketë kosto shtesë, që duhet të adresohet në fazat e ardhshme të përgaditjes së buxhetit.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se komisioni, unanimit, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-029 për mbrojtje dhe siguri bërthamore, përmban kosto të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Amendamentet e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, nuk përmbajnë kosto buxhetore shtesë.

7. Projektligji nr.06/L-037 për Metrologji dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Kryetari - theksoi se në bazë të Deklaratës Financiare të Ministrisë së Financave, shifet se Projektligji nuk përmbanë kosto shtesë buxhetore. Kam diskutuar me Ministrin e Financave, dhe ka thënë se kostoja buxhetore është e përballueshme. Ndërsa, amendamentet e Komisionit Funksional, nuk përmbajnë kosto buxhetore shtesë.

Zëvendës-Ministri i Financave – janë paraparë dy zyrtarë të rinj për Metrologji dhe buxheti për paga për ta për vitin 2018. Për vitin 2018, nuk ka kosto shtesë buxhetore, për vitet e ardhshme do të ketë kosto shtesë, që duhet të adresohet në fazat e ardhshme të përgaditjes së buxhetit.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se komisioni, unanimit, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-037 për Metrologji, përmban kosto të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, nuk përmbajnë kosto buxhetore shtesë.

8. Projektligji nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Kryetari - theksoi se në bazë të Deklaratës Financiare të Ministrisë së Financave, shifet se Projektligji nuk përmbanë kosto shtesë buxhetore. Por as amendamentet e Komisionit Funksional, nuk përmbajnë kosto buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se komisioni, unanimisht, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit dhe amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, nuk përmbajnë kosto buxhetore shtesë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:35.

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari komisionit,

Lumir Abdixhiku